



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 500 Akti

Nr. 623 Vendimi
Tiranë, më 15.2.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Etleda Çiftja	Relatore
Alma Faskaj	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prezencë edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 14.2.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mbylli seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Selvie Gjoçaj**, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet A, B, C, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Selvie Gjoçaj

dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, e cila në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Znj. Selvie Gjoçaj, në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179, germa “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, ka mbajtur funksionin e gjyqtarës pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për rrjedhojë, në zbatim të pikës 3 të kësaj dispozite dhe parashikimit të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, gëzon statusin e subjektit të rivlerësimit dhe i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.

2. Znj. Selvie Gjoçaj, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.6.2020 me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Suela Zhegu, Alma Faskaj dhe Etleđa Çiftja.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; si dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin datë 15.6.2020, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Suela Zhegu. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 7.8.2020, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe mbi përbërjen e trupit gjykues, si dhe i kërkoi të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Komisioni, gjithashtu, i kërkoi subjektit informacion shtesë sipas pyetësorit standard.

6. Trupi gjykues, me vendimin datë 1.2.2023, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit Selvie Gjoçaj, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, sipas ligjit nr. 84/2016, të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; si dhe (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin

¹Email datë 7.8.2020, ora 09:52, “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta dhe po në të njëjtën datë 1.2.2023, përmes postës elektronike², i njoftoi subjektit të rivlerësimit vendimin mbi përfundimin e hetimit paraprak.

7. Në datën 9.2.2023 subjekti i rivlerësimit paraqiti me anë të postës elektronike³ dhe dokumentacionit të protokolluar pranë Komisionit me shkresën nr. *** prot., datë 9.2.2023, pretendimet e saj me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht.

8. Më tej, subjekti i rivlerësimit u njoftua me anë të postës elektronike⁴ se trupi gjykues, me vendimin e datës 10.2.2023, vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 14.2.2023, ora 10:00, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

9. Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Selvie Gjoçaj, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; si dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

10. Në datën 14.2.2023 u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë.

11. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryera mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

12. Znj. Selvie Gjoçaj, pasi dëgjoi relacionin, shprehu qëndrimin e saj, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj.

13. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Selvie Gjoçaj, duke u bazuar mbi të tria kriteret e rivlerësimit.

14. Seanca dëgjimore e datës 14.2.2023 u ndërpre, për të rifilluar në datën 15.2.2023, ora 09:45, për shpalljen e vendimit.

15. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 14.2.2023, subjekti i rivlerësimit Selvie Gjoçaj kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

16. Subjekti i rivlerësimit Selvie Gjoçaj ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

²Email datë 1.2.2023, ora 14:09, "Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin e rivlerësimit".

³Email datë 9.2.2023, ora 11:38, "Parashtrime mbi rezultatet e hetimit".

⁴Email datë 10.2.2023, ora 12:40, "Komisioni – Ftesë për seancë dëgjimore lidhur me procesin tuaj të rivlerësimit".

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

17. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

18. Sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit; (iii) KLGJ-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili, në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

19. Referuar vendimit nr. 2/20175 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

20. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Selvie Gjoçaj, e cila është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2006, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

21. Subjekti i rivlerësimit në datën 26.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar se:

⁵Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni, ndërsa sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

22. Për efekt të procesit të rivlerësimit, personi që është hetuar si i lidhur me subjektin e rivlerësimit është z. R. G., si rezultat i dhënies së huas në shumën 30.000 euro në datën 2.6.2015.

23. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting* të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2006 – 2016; (ç) provat shkrese/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaramet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; si dhe (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit dhe, në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

24. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarameve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarameve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017 nga subjekti i rivlerësimit

1. Apartament me sip. 104,02 m², në rrugën “**”, Tiranë, në vlerën 56.000 euro**

1.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron apartament me sip. 104,02 m², me adresë rruga “****” përballë ***, hyrja ***, kati ***, ap. ***, blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., me kontratë shitjeje me rezervë pronësie nr. ***, datë 3.6.2015, me notere publike A. Ç., regjistruar pranë ZVRPP-së Tiranë me nr. pasurie ***, z. k. ***, pajisur me certifikatë pronësie datë 9.6.2015, liruar hipoteka me deklaratë noteriale nr. *** (deklarues “****” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori B. U.), hipotekuar në favor të Bankës Kombëtare Tregtare, dega “****”, me kontratë hipotekimi nr. ***, datë 19.6.2015, me hipotekuese Selvie Gjoçaj. Kreditor/përfutues Banka Kombëtare Tregtare. Vlera: 56.000 euro. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i krijimit: kredi bankare në BKT në vlerën 4.200.000 lekë dhe hua në vlerën 30.000 euro nga

huadhënësi R. G.. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁶.

1.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se në DIPP/2015 subjekti ka deklaruar të njëjtën sa deklararon në deklaratën *Vetting* lidhur me këtë apartament të blerë në shumën 56.000 euro. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka paraqitur kontratën e shitjes së pasurisë me rezervë nr. ***, datë 3.6.2015, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë blerëse Selvie Gjoçaj, të pasurive:

- i. apartament me sipërfaqe të shfrytëzueshme 104,02 m², sipërfaqe totale 118,01 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me adresë rruga “****” përballë ***, k. ***, ap. ****, shk. ***, Tiranë, në vlerën 56.000 euro;
- ii. garazh me sipërfaqe të shfrytëzueshme 23 m², sipërfaqe totale 45,18 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me adresë rruga “****” përballë ***, k. ***, ap. ***, shk. ***, Tiranë, në vlerën 4.000 euro.

1.3. Referuar kontratës, shuma 30.000 euro do të paguhet menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe me pagesën e kësaj shume konsiderohet i likuiduar çmimi i pasurisë së paluajtshme garazh dhe pjesërisht çmimi i apartamentit. Diferenca prej 30.000 euro e çmimit do të paguhet nga blerësi nëpërmjet kreditimit nga institucionet financiare bankare, jo më vonë se 6 muaj nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate. Blerësit i janë vënë në dispozicion pasuritë e paluajtshme përpara nënshkrimit të kësaj kontrate, pranuar dhe marrë në dorëzim pa rezervë.

1.4. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur transfertën e kryer të shumës 30.000 euro në datën 3.6.2015 nga llogaria e saj në BKT në llogari të noterës publike A. Ç. për blerjen e pasurive të paluajtshme apartament dhe garazh.

1.5. Më tej, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 3.6.2015, në të cilën palët “****” sh.p.k. dhe subjekti i rivlerësimit deklarojnë se kanë lidhur në datën 3.6.2015 kontratën e shitblerjes me rezervë të pasurisë së paluajtshme, sipas së cilës znj. Selvie Gjoçaj do të paguajë ndaj kësaj shoqërie shumën 30.000 euro, brenda një periudhe 3-mujore nga data e nënshkrimit të kontratës së shitjes me rezervë (pra jo 6 muaj siç parashikohet në pikën 2.3.2 të kontratës). Palët bien dakord se me kalimin e afatit të mësipërm shuma 30.000 euro, për çdo pjesë të pashlyer të saj, përbën titull ekzekutiv në kuptim të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile dhe mund të kërkohet ekzekutimi i tij në çdo kohë nga shoqëria “****” sh.p.k.

1.6. Sipas certifikatës së pronësisë nr. ***, lëshuar në datën 12.5.2015, pasuria apartament nr. ***, me sip. 104,02 m², është e regjistruar në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k. Kjo shoqëri ka ndërtuar objektin “strukturë 9 kate banimi dhe shërbime, 2 kate nën tokë”, miratuar me lejen e ndërtimit nr. ***, datë 8.11.2013.

Më tej, kjo pasuri ka kaluar në pronësi të subjektit, vërtetuar me certifikatën e pronësisë nr. ***, datë 9.6.2015. Referuar kartelës së pasurisë, në seksionin e hipotekave është shënuar “*Pasuria*

⁶Kontratë shitjeje pasurie me rezervë nr. ***, datë 3.6.2015; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, lëshuar në datën 12.5.2015; kartelë e pasurisë së paluajtshme plan rievimi e pasurisë; prokurë e përgjithshme datë 24.9.2010, leje zhvillimi ndërtimi datë 8.11.2013, për shoqërinë “****” sh.p.k.; transferim nga llogaria në BKT datë 3.6.2015, deklaratë noteriale nr. ***, datë 3.6.2015, certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, kartelë e pasurisë nr. ***, deklaratë noteriale për lirim hipoteke datë 1.7.2015; transferim nga llogaria në llogari, datë 30.6.2015, kontratë kredie bankare nr. ***, datë 19.6.2015; kontratë hipotekimi nr. ***, datë 19.6.2015, kontratë huaje nr. ***, datë 2.6.2015; deklaratë datë 18.10.2016, e shtetasit R. G..

bllokohet në favor të palës shitëse deri në likuidimin e plotë të çmimit (kontrata e shitjes me rezervë datë 3.6.2015, noter A. Ç.)”.

1.7. Në datën 1.7.2015 shoqëria “***” sh.p.k., me përfaqësues shtetasin B. U., ka lëshuar deklaratën noteriale për lirim hipoteke nr. ***, sipas së cilës konfirmohet se subjekti i rivlerësimit ka shlyer rezervën e mbetur në shumën 30.000 euro në datën 30.6.2015 dhe e ka kaluar këtë shumë në llogarinë bankare (llogari tjetërsimi) të noteres A. Ç. nëpërmjet BKT-së dhe më pas kjo shumë ka kaluar me transfertë bankare nga llogari e noteres në llogari të shitësit “***” sh.p.k. po në datën 30.6.2015. Duke qenë se është likuiduar plotësisht çmimi sipas kontratës, autorizohet ZVRPP-ja Tiranë që të kryejë veprimet e nevojshme për lirim të pronës⁷.

1.8. Referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK Drejtoria Vendore Tiranë⁸, konfirmohet se në emër të subjektit të rivlerësimit Selvie Gjoçaj rezulton e regjistruar pasuria apartament me sip. 104,02 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, vërtetuar me anë të kartelës së pasurisë regjistruar në datën 9.6.2015⁹.

1.9. Me qëllim analizimin e vlerës së blerjes së këtij apartamenti dhe nëse ka pasur apo jo ndonjë trajtim preferencial për subjektin, Komisioni iu referua udhëzimit nr. ***, datë 30.9.2015, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2015”. Bazuar në këtë udhëzim, referuar tabelës nr. 3 “Të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve në qytetin e Tiranës për vitin 2015”, vlera në tregun e lirë përllogaritet: (i) 8.850.750 lekë¹⁰ për apartamentin (përkundrejt çmimit 7.892.080 lekë¹¹ të paguar nga subjekti); dhe (ii) 1.207.500 lekë¹² për garazhin (përkundrejt çmimit 563.720 lekë¹³ të paguar nga subjekti).

1.10. Nga hetimi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës¹⁴, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës¹⁵ dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë¹⁶, nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit me shitësit/ndërtuesit e këtij apartamenti.

Burimi i krijimit

i. Kontratë huaje në shumën 30.000 euro

1.11. Në deklaratën *Vetting* dhe në DIPP/2015, subjekti ka deklaruar huan e marrë nga shtetasi R. G. në shumën 30.000 euro, me anë të kontratës së huas nr. ***, datë 2.6.2015. Afati i kthimit të huas do të jetë 2 vjet, sipas mundësive të huamarrësit, brenda periudhës 2.6.2015 – 2.6.2017. Në kontratë specifikohet se shuma 30.000 euro ka kaluar nga huadhënësi tek huamarrësi nëpërmjet bankës.

⁷E vërtetuar me anë të transfertave të kryera në BKT: në datën 3.6.2015 nga subjekti i rivlerësimit në llogari të noteres A. Ç. të vlerës së mbetur për blerje apartamenti në shumën 30.000 euro (4.200.000 lekë, kursi i këmbimit 140,4 lekë); e më tej, në datën 3.6.2015 nga noterja A. Ç. në llogari të shoqërisë “***” sh.p.k. (kësti i dytë) shuma 30.000 euro.

⁸Shkresë nr. *** prot., datë 30.9.2020.

⁹Vërtetuar gjithashtu sipas dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, ZVRPP Tiranë, shkresa nr. *** prot., datë 12.12.2017.

¹⁰Sipërfaqe totale 118,01 m² x 75.000 lekë/m².

¹¹56.000 euro x 140,93 lekë (kursi i këmbimit, referuar faqes zyrtare të Bankës së Shqipërisë, datë 3.6.2015, 1 euro = 140,93 lekë).

¹²23 m² x 75.000 lekë/m² x 70%.

¹³4.000 euro x 140,93 lekë (kursi i këmbimit, referuar faqes zyrtare të Bankës së Shqipërisë, datë 3.6.2015, 1 euro = 140,93 lekë).

¹⁴Shkresë nr. *** prot., datë 11.11.2022.

¹⁵Shkresë nr. *** prot., datë 7.11.2022.

¹⁶Shkresë nr. ***, datë 9.11.2022.

1.12. Në lëvizjet e llogarive bankare të huadhënësit të përcjella nga BKT-ja¹⁷ u konstatua se në datën 1.6.2015 është kryer një depozitim me vlerë 31.000 euro, me përshkrimin “B. D. punonjës, derdh në llogari”. Më tej, në datën 2.6.2015, shuma 30.000 euro është transferuar në favor të subjektit, me përshkrimin “dhënie huaje pa interes për blerje apartamenti”. Komisioni, me anë të *email*-it datë 9.11.2022, e ka pyetur subjektin nëse është në dijeni të llojit të marrëdhënies që ka ekzistuar midis depozituesit të shumës 31.000 euro në llogarinë e huadhënësit dhe vetë huadhënësit. Në përgjigje¹⁸, subjekti deklaroi se nuk është në dijeni të llojit të marrëdhënies mes tyre dhe se nuk njeh ndonjë person me emrin B. D.

Në datën 3.6.2015 subjekti e ka kaluar shumën 30.000 euro në llogarinë e noteres A. Ç.. Gjithsesi, Komisioni, për efekt të procesit të rivlerësimit, mori në konsideratë faktin se mbajtësi i llogarisë është shtetasi R. G., pra huadhënësi, dhe se transferimi i fondeve është kryer nga kjo llogari tek llogaria e subjektit, sipas deklaramit të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit bashkëlidhur.

1.13. Me anë të pyetësorit nr. 2¹⁹, subjektit iu kërkua të paraqesë vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, që provon se nuk ka shqyrtuar ndonjë çështje gjyqësore me palë shtetasin B. D., për efekt të konfliktit të interesit. Në përgjigje²⁰, subjekti deklaroi se: *“Siç dhe ju kam sqaruar në përgjigje të pyetjes tuaj, të dërguar me email, datë 9.11.2022 (përgjigje e paraqitur pranë jush në datën 10.11.2022, protokolluar me nr. *** prot.) unë nuk kam qenë në dijeni të marrëdhënies së huadhënësit z. R. G. me shtetasin B. D.. Nisur nga sa kërkohet, unë i kam kërkuar z. R. G. të më japë informacion me shkrim për këtë shtetas në lidhje me marrëdhënien mes tyre. Me anë të vërtetimit nr. *** prot., datë 23.1.2023, lëshuar nga z. R. G., në cilësinë e administratorit të shoqërisë ‘***’ sh.p.k., vërtetohet se: Z. B. D., me ID ***, ka qenë i punësuar pranë kompanisë ‘***’ sh.p.k., me NIPT *** (hotel ‘***’) dhe përfaqësues ligjor i z. R. G. në pozicionin arkëtar për periudhën 21.6.2013 – 3.7.2015”.*

1.14. Për të provuar deklaramet e saj, në cilësinë e provës, subjekti ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga shoqëria “***” sh.p.k., me administrator shtetasin R. G. Më tej, ka paraqitur formularin nr. ***, datë 19.6.2013, “*** - pasqyra e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe të larguarve nga puna”, për tatimpaguesin “***” sh.p.k., periudha tatimore viti 2013, muaji qershor, ku pasqyrohen të dhënat e datës së fillimisht të punës së shtetasit B. D. pranë kësaj shoqërie, si dhe “deklaratë e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe të larguarve nga puna” nr. ***, datë 7.7.2015, për tatimpaguesin “***” sh.p.k., periudha tatimore viti 2015, muaji korrik, ku pasqyrohen të dhënat e datës së largimit nga puna pranë shoqërisë “***” sh.p.k. të shtetasit B. D..

1.15. Komisioni vëren se shtetasi B. D. është punësuar pranë shoqërisë “***” sh.p.k. në datën 21.6.2013, në pozicionin llogaritar dhe është larguar nga kjo detyrë në datën 3.7.2015.

1.16. Në përfundim, subjekti deklaroi se në përgjigjen me shkrim paraqitur pranë Komisionit, në datën 10.11.2022, protokolluar me nr. *** prot., ka deklaruar se nuk njeh asnjë person me emrin B. D.. Subjekti paraqiti vërtetimet nr. *** prot., datë 24.1.2023, lëshuar nga Gjykata e Rrethit

¹⁷Shkresë nr. *** prot., datë 27.7.2020.

¹⁸Dokumentacioni i protokolluar në Komision me nr. ***, datë 10.11.2022.

¹⁹*Email* datë 23.1.2023, ora 10:41.

²⁰Dokumentacioni i protokolluar në Komision me nr. ***, datë 26.1.2023 dhe *email* datë 26.1.2023, ora 14:40.

Gjyqësor Kukës, nr. *** prot., datë 24.1.2023, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe nr. *** prot., datë 24.1.2023, lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë²¹, sipas të cilave rezultoi se nga verifikimet e kryera për periudhat që subjekti ka ushtruar detyrën pranë këtyre gjykatave, nuk ka pasur në shqyrtim çështje ku palë të ketë qenë shtetasi B. D.

1.17. Sa më sipër rezultoi, Komisioni vëren se nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit me shtetasin B. D.

1.18. Lidhur me burimet e ligjshme financiare të huadhënësit/shtetasit R. G., ky shtetas ka deklaruar²² se burimi i të ardhurave të huas së dhënë është si rezultat i dividendëve të marrë gjatë viteve nga shoqëria që ky shtetas zotëron, “****” sh.p.k., me NIPT *** dhe nga ish-shoqëria “****” sh.a., me NIPT ***, tashmë e përthithur nga shoqëria “****” sh.p.k.

Subjekti ka bashkëlidhur ekstraktin historik të shoqërisë “****” sh.p.k., themeluar në datën 18.3.1994, me objekt veprimtarie “import, eksport, tregtim me shumicë e pakicë të mallrave të ndryshëm ushqimorë, industrialë, elektroshtëpiake, karburante, ndërtim etj.”. Shtetasi R. G. figuron administrator dhe ortak i vetëm i kësaj shoqërie. Bashkëlidhur janë paraqitur dy urdhërhirime të shoqërisë “****” sh.a., konkretisht urdhërhirim nga “Alpha Bank”, datë 24.7.2009, me vlerë 12.397.739 lekë, me përshkrimin “pagesë tatim në burim ‘****’ sh.a., NIPT ***, dividend 2004 – 2008, për R. G.” dhe urdhërhirim nga “****”, datë 22.7.2011, me vlerë 8.000.000 lekë, me përshkrimin “likuidim tatim në burim (10%) për shpërndarje dividendi R. G. të periudhës 2010”.

1.19. Në pyetësorin standard, subjekti ka paraqitur një dokument me lëndë “Analizë mbi dividendin e derdhur në favor të z. R. G.”, datë 23.7.2020, nënshkruar nga shtetasi R. G., si dhe 9 urdhërhirime bankare të shoqërisë “****” sh.a. në favor të shtetasit R. G. dhe 2 urdhërhirime bankare të shoqërisë “****” sh.a. po në favor të këtij shtetas.

1.20. Referuar tabelës së pasqyruar në këtë dokument, shtetasi R. G., gjatë periudhës 2002 – 2011, ka përfituar dividend *neto* në vlerën totale 505.118.042 lekë, konkretisht: (i) 215.902.461 lekë nga shoqëria “****” sh.p.k.; (ii) 277.179.647 lekë nga shoqëria “****” sh.a.; dhe (iii) 12.035.935 lekë nga shoqëria “****” sh.a.

1.21. Në vijim, Komisioni analizoi dividendët e përfituar nga shtetasi R. G. nga secila shoqëri, si vijon:

a) *Lidhur me dividendin e përfituar nga shoqëria “****” sh.a.*

1.22. Referuar ekstraktit të QKB-së²³, shoqëria “****” sh.a. është themeluar në datën 12.5.2004, me objekt aktiviteti hoteleri-turizëm. Shtetasi R. G. figuron aksioner me të drejtë vote dhe me përqindje pjesëmarrjeje 40%. Në datën 12.1.2012 kjo shoqëri ka kaluar me status “çregjistruar”²⁴.

²¹Konfirmuar edhe nga hetimi i Komisionit me shkresën nr. ***prot., datë 24.1.2023, lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

²²Vërtetim nënshkrimi noterial nr. *** rep., datë 18.10.2016.

²³Shkarkuar nga faqja zyrtare e QKB-së.

²⁴Përshkrimi i çështjes në ekstraktin e QKB-së: “Pasqyrimi në historikun e veprimeve të kryera të miratimit të aplikimit sipas vërtetimit të kryerjes së regjistrimeve të tjera, datë 19.12.2011, për përfundimin e procesit të bashkimit me përthithje të shoqërisë ‘****’ sh.p.k. (shoqëria përthithëse) me shoqërinë ‘****’ sh.a. dhe shoqëria ‘****’ sh.a. (shoqëri të përthithura)”.

1.23. Nga analizimi i dokumentacionit të përcjellë nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj²⁵ rezulton se shoqëria “****” sh.a. ka marrë këto vendime: (i) vendimi nr. *** i Mbledhjes së Zakonshme të Asamblesë së Përgjithshme, datë 30.6.2009, për shpërndarjen e dividendit të vitit 2008 dhe atij të akumuluar në vite i papërdorur në investime, konkretisht për shtetasin R. G. është shpërndarë dividend *bruto* në vlerën 123.977.385 lekë²⁶. Tatimi mbi dividendin në vlerën 12.397.739 lekë rezulton i paguar nga shoqëria “****” sh.a. në datën 24.7.2009²⁷; (ii) vendimi datë 31.8.2010, për shpërndarjen e fitimit të vitit 2009, konkretisht për shtetasin R. G. është shpërndarë dividend *bruto* në vlerën 64.000.000 lekë²⁸. Tatimi mbi dividendin në vlerën 6.400.000 lekë rezulton i kompensuar nga administrata tatimore sipas shkresës nr. *** prot., dt. 22.10.2012, e Drejtorisë së Menaxhimit dhe Përpunimit të të Ardhurave; (iii) vendimi datë 27.4.2011, për shpërndarjen e fitimit të vitit 2010, konkretisht për shtetasin R. G. është shpërndarë dividend *bruto* në vlerën 80.000.000 lekë²⁹. Tatimi mbi dividendin në vlerën 8.000.000 lekë rezulton i paguar nga shoqëria “****” sh.a. në datën 22.7.2011³⁰.

1.24. Për vitin ushtrimor 2011 Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj nuk ka përcjellë informacion apo dokumentacion bashkëlidhur.

1.25. Sa më lart, rezulton se dividendi *neto* i përfituar nga shtetasi R. G. nga shoqëria “****” sh.a. ka qenë në vlerën 241.179.647 lekë.

1.26. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarive bankare të shtetasit R. G. pranë “Credins Bank”³¹, konfirmohet se gjatë viteve 2009 – 2011, shoqëria “****” sh.a. ka transferuar për llogari të këtij shtetasi dividend në vlerën totale 43.956.653 lekë dhe 1.466.021 euro.

1.27. Më tej, vërehet se shtetasi R. G. ka kryer transaksione të ndryshme, të tilla si kalim në depozita, transferata për të tretë dhe tërheqje *cash*. Ndër të tjera, evidentohen disa tërheqje *cash*, të cilat kanë burim fillestar pikërisht dividendin e përfituar, konkretisht gjatë periudhës 2009 - 2010 ka tërhequr 810.000 euro dhe gjatë vitit 2011 ka tërhequr 7.000.000 lekë dhe 147.000 USD.

1.28. Për rrjedhojë të sa më lart, duket se shtetasi R. G. ka pasur mundësi të disponojë *cash* vlerën e huas prej 30.000 euro, dhënë subjektit të rivlerësimit në datën 2.6.2015.

*b) Lidhur me dividendin e përfituar nga shoqëria “****” sh.p.k.*

1.29. Referuar ekstraktit të QKB-së³², shoqëria “****” sh.p.k. është themeluar në datën 17.3.1994 dhe shtetasi R. G. figuron administrator dhe ortak i vetëm i kësaj shoqërie.

²⁵Me shkresën nr. *** prot., datë 23.11.2022, Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj ka përcjellë vetëm dokumentacion bashkëlidhur.

²⁶Referuar tabelës bashkëlidhur, shkresës nr. *** prot., datë 1.10.2012, të shoqërisë “****” sh.a., drejtuar Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, e përcjellë pranë Komisionit nga DTM-ja, dividendi *neto* për periudhën 2004 – 2008, për shtetasin R. G., është përlogaritur në vlerën 111.579.647 lekë.

²⁷Urdhërhyrja nga “Alpha Bank”, datë 24.7.2009, në vlerën 12.397.739 lekë, me përshkrim “Pagesë tatim në burim ‘****’ sh.a., NIPT ***, dividend 2004 – 2008 për R. G.”.

²⁸Referuar shkresës nr. *** prot., datë 31.8.2010, të shoqërisë “****” sh.a., drejtuar Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, rezulton se dividendi *neto* për vitin ushtrimor 2009, për shtetasin R. G., është përlogaritur në vlerën 57.600.000 lekë.

²⁹Referuar shkresës nr. *** prot., datë 27.4.2011, të shoqërisë “****” sh.a., drejtuar Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, rezulton se dividendi *neto* për vitin ushtrimor 2010, për shtetasin R. G., është përlogaritur në vlerën 72.000.000 lekë.

³⁰Urdhërhyrja nga “****”, në vlerën 8.000.000 lekë, me përshkrim “Likuidim tatim në burim (10%) për shpërndarje dividendi R. G. të periudhës 2010”.

³¹Shkresë nr. *** prot., datë 5.1.2023.

³²Shkarkuar nga faqja zyrtare e QKB-së.

1.30. Nga analizimi i dokumentacionit të përcjellë nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj³³, shoqëria “****” sh.p.k. ka marrë vendim për shpërndarje dividendi në vlerën 23.000.000 lekë nga fitimi i vitit 2006, në vlerën 20.000.000 lekë nga fitimi i vitit 2007 dhe në vlerën 106.277.570 lekë nga fitimi i vitit 2009, pra në total dividend *bruto* në vlerën 149.277.569 lekë³⁴.

1.31. Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj nuk ka konfirmuar pagesën e tatimit mbi dividendin, por ka përcjellë korrespondencën midis sektorëve të kësaj drejtorie, konkretisht ka përcjellë shkresat që Sektori i Vlerësimit, Rimbursimit, Mbledhjes dhe Masave Shtrënguese i ka dërguar Zyrës së Kontabilitetit për kontabilizimin e tatimit mbi dividendin, në vlerën totale 14.927.757 lekë³⁵.

1.32. Sa më lart, rezulton se dividendi *neto* i përfituar nga shtetasi R. G. nga shoqëria “****” sh.p.k. për periudhën e analizuar ka qenë në vlerën 134.349.812 lekë.

*c) Lidhur me dividendin e përfituar nga shoqëria “****” sh.a.*

1.33. Referuar ekstraktit të QKB-së³⁶, shoqëria “****” sh.a. është themeluar në datën 30.9.2009, me objekt “objekti i shoqërisë do të përfshijë, por pa u kufizuar, aktivitetet e mëposhtme: (i) pjesëmarrja në kapital; (ii) zhvillimi i aktivitetit të hoteleri-turizmit”.

Në datën 14.9.2010 shtetasi R. G. është shtuar si aksioner me të drejtë vote dhe me përqindje pjesëmarrjeje 6,67%. Në datën 12.1.2012 kjo shoqëri ka kaluar me status “çregjistruar”.

1.34. Me anë të vendimit nr. ***, datë 18.5.2011, të Mbledhjes së Asamblesë së Jashtëzakonshme të shoqërisë “****” sh.a.³⁷, është vendosur miratimi i shpërndarjes së dividendit për vitin 2010.

1.35. Bazuar në informacionin e përcjellë nga DRT-ja Tiranë³⁸, rezulton se kjo shoqëri ka realizuar një fitim prej 92.286.596 lekësh për vitin 2010 dhe 105.120.152 lekë për vitin 2011. Lidhur me pagesën e tatimit mbi dividendin, DRT-ja informon se është paguar tatim mbi dividendin në vlerën totale 1.236.731 lekë³⁹ për vitin 2010, ndërsa për vitin 2011 nuk është paguar dividend.

1.36. Referuar tabelës së pasqyruar në dokumentin e paraqitur në pyetësonin standard (referojuni paragrafit nr. 1.20), vlera *bruto* e fitimit të shpërndarë për shtetasin R. G. ka qenë 13.373.261 lekë⁴⁰, tatimi 1.337.326 lekë dhe dividendi 12.035.935 lekë. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur dy urdhërshirime bankare të shoqërisë “****” sh.a. në favor të shtetasit R. G., konkretisht në datën 25.3.2011, në vlerën 36.018 euro, me përshkrimin “ndarje paraprake dividendi viti 2010” dhe në datën 27.4.2011, në vlerën 12.863 euro, me përshkrimin “ndarje pjesore dividendi viti 2010”.

³³Me shkresën nr. *** prot., datë 23.11.2022, Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj ka përcjellë vetëm dokumentacionin bashkëlidhur.

³⁴Bashkëlidhur shkresat nr. *** prot., datë 30.7.2007, nr. *** prot., datë 21.7.2008 dhe nr. *** prot., datë 19.7.2010, për përcjelljen e vendimeve të ortakut të shoqërisë për përdorimin e fitimit.

³⁵Bashkëlidhur shkresat nr. *** prot., datë 21.8.2007, nr. *** prot., datë 17.11.2008 dhe nr. *** prot., datë 23.7.2010, për kontabilizimin e tatimit mbi dividendin e shoqërisë “****” sh.p.k., në vlerat 2.300.000 lekë, 2.000.000 lekë dhe 10.627.757 lekë.

³⁶Shkarkuar nga faqja zyrtare e QKB-së.

³⁷Dokument i shkarkuar nga ekstrakti historik i kësaj shoqërie në faqen zyrtare të QKB-së.

³⁸Me shkresë nr. *** prot., datë 17.11.2022, DRT-ja ka përcjellë: (i) formularët e deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi fitimin për vitet 2010 dhe 2011; dhe (ii) pasqyrat financiare për vitin 2010.

³⁹Vlera 782.546 lekë në datën 26.4.2011 dhe vlera 454.185 lekë në datën 7.11.2011.

⁴⁰Pothuajse e barabartë me pjesën takuese mbi fitimin total të realizuar (6,67% x 197.406.748 lekë = 13.160.436 lekë).

1.37. Nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të shtetasit R. G. pranë OTP Bank⁴¹, vërehet se ky shtetas ka kryer një tërheqje në datën 7.6.2011, me vlerë 49.600 euro, përshkrim “tërhequr nga R. G.”. Burim i kësaj shume të tërhequr janë transfertat e kryera nga shoqëria “****” sh.a. për pagesën e dividendit.

1.38. *Më tej, Komisioni analizoi shlyerjen e kësaj huaje – në pyetësonin standard⁴² subjekti ka deklaruar se kjo hua është dhënë pa interes dhe kushte të tjera dhe me opsionin e kthimit të saj sipas mundësive, brenda një afati 2-vjeçar. Në kushtet kur nuk u bë i mundur kthimi i shumës brenda afatit, me deklaratën noteriale nr. ***, datë 30.9.2017, është shtyrë afati i kthimit deri më 2.6.2019, duke rënë dakord që kushtet e tjera të kontratës së huas mbeten të pandryshuara. Në kushtet kur edhe brenda këtij afati nuk u bë i mundur kthimi i shumës, me anë të deklaratës noteriale nr. ***, datë 4.7.2019, është shtyrë përsëri afati deri më 2.6.2021. Subjekti sqaron se deri më tani nuk ka kthyer asnjë pjesë të shumës dhe se së bashku me bashkëshortin e saj B. H. janë duke mbledhur kursimet e përbashkëta në bankë me qëllim që brenda afatit 2.6.2021 të kthejnë të plotë shumën 30.000 euro. Konkretisht, kanë hapur një depozitë bankare (në bashkëpronësi me bashkëshortin) në “Credins Bank”, krijuar me kursime nga paga. Po kështu, në emër të bashkëshortit B. H. është hapur një llogari depozitë plus pranë “Credins Bank”, krijuar nga data 7.9.2019 e në vijim, duke mbajtur çdo muaj nga paga e tij shumën 100.000 lekë. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti deklaratat noteriale nr. ***, datë 30.9.2017 dhe nr. ***, datë 4.7.2019, kontratë depozite, të dhëna për llogari depozite në emër të shtetasit B. H.*

1.39. Komisioni, me anë të pyetësonit nr. 1⁴³, i kërkoi subjektit të deklarojë marrëdhënien me shtetasin R. G., si dhe nëse është bërë shlyerja e kësaj huaje deri më tani. Në përgjigje⁴⁴ subjekti deklaroi se shtetasin R. G. e ka njohur në qershor të vitit 2015 nga ish-vjehri i motrës së saj, ku këta dy të fundit janë kushërinj me njëri - tjetrin. Subjekti deklaroi se nuk ka pasur dhe nuk ka asnjë lidhje gjinore, shoqërore apo për shkak të punës me shtetasin R. G., i cili ishte shprehur i gatshëm t’i jepte hua shumën 30.000 euro.

1.40. *Më tej, subjekti deklaroi se i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi për zgjidhjen e martesës me shtetasin B. H.. Mosmarrëveshjet mes tyre u bënë shkak që të mos respektonte sërish afatin për kthimin e huas në datën 2.6.2021, qoftë edhe pjesërisht, pasi ish-bashkëshorti nuk binte dakord të pjesëtonin kursimet e krijuara gjatë jetesës së përbashkët derisa të përfundonte gjykimi për zgjidhjen e martesës. Subjekti sqaron se këtë situatë ia kishte bërë prezent shtetasi R. G. dhe kishte gjetur mirëkuptimin e tij në mënyrë verbale që të mund të kthente huan brenda vitit 2021 në të njëjtat kushte sipas kontratës. Subjekti deklaroi se huaja është kthyer në 4 këste, në mënyrat, datat dhe shumat si vijon:*

i. *Kësti i parë 8.000 euro, krijuar me të ardhurat e subjektit nga paga. Subjekti deklaroi se në datën 11.6.2021 ka tërhequr nga llogaria e pagës pranë BKT-së shumën 980.000 lekë, konvertuar në euro jashtë bankës, shtuar edhe 100 euro cash dhe në total shumën 8.000 euro e*

⁴¹Shkresë nr. *** prot., datë 21.11.2022.

⁴²Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.7.2020.

⁴³Email datë 3.11.2022, ora 12:32.

⁴⁴Dokumentacioni i protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 10.11.2022.

ka derdhur *cash* në llogarinë e saj pranë “Credins Bank” dhe më pas e ka transferuar në llogarinë e shtetasit R. G. në datën 11.6.2021.

- ii. *Kësti i dytë* 8.000 euro është marrë hua nga shtetasi E. M. Subjekti sqaron se huaja është marrë sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 22.6.2022, me deklarues shtetasit E. M. dhe Selvie Gjoçaj (pa interes dhe me afat shlyerje deri në datën 21.6.2024) dhe se shuma 8.000 euro ka kaluar nga llogaria e shtetasit E. M. pranë BKT-së në llogarinë e subjektit pranë “Credins Bank”, në datën 22.6.2021. Më pas, vijon subjekti, këtë shumë e ka transferuar në llogarinë e shtetasit R. G. pranë “Credins Bank” në datën 25.6.2021.
- iii. *Kësti i tretë* 8.000 euro është krijuar si rezultat i pjesëtimit të disa të ardhurave me ish-bashkëshortin B. H. pas zgjidhjes së martesës, në bazë të deklaratës noteriale nr. ***, datë 22.10.2021, më konkretisht: (1) depozitë sipas kontratës së depozitës me afat nr. ***, datë 7.9.2019, lidhur mes “Credins Bank”, subjektit dhe shtetasit B. H. në cilësinë e depozituesit, krijuar me kursime nga paga. Pas zgjidhjes së martesës, kur kjo depozitë u maturua, kanë bërë pjesëtimin e shumës bazë të depozitës prej 800.000 lekësh dhe të interesave prej 19.822,46 lekësh, duke marrë secili 50% të shumës totale; (2) të ardhurat nga një depozitë plus e krijuar pranë “Credins Bank” me nr. ***, datë 7.9.2019, nga ish-bashkëshorti B. H. me kursime nga paga si oficer i policisë gjyqësore pranë Prokurorisë së Përgjithshme për periudhën shtator 2019 – gusht 2021, në shumën 104.576,76 lekë. Pas zgjidhjes së martesës kjo shumë është pjesëtuar duke përfutur secili 50% dhe subjekti ka përfutur shumën 552.288,38 lekë në datën 22.10.2021 pranë “Credins Bank”.

Të dyja shumat e sipërcituara, në total 961.931,46 lekë, subjekti deklaron se i ka konvertuar në euro dhe kaluar në llogarinë e saj 7.884,68 euro pranë “Credins Bank” në datën 22.10.2021. Në datën 25.10.2021 ka derdhur edhe një pjesë *cash* dhe në total shumën prej 8.000 euro e ka kaluar në llogari të shtetasit R. G..

- iv. *Kësti i katërt* 6.000 euro është krijuar duke marrë hua nga e motra F. I. shumën prej 3.000 euro, sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 18.11.2021, me deklarues shtetasit F. I. dhe Selvie Gjoçaj. Huaja e marrë është pa interes dhe me afat shlyerjeje deri më 18.11.2025, dhënë dorazi. Subjekti sqaron se ka shtuar edhe 3.000 euro të tjera, krijuar me të ardhurat nga paga si gjyqtare përgjatë vitit 2021 dhe shumën totale prej 6.000 euro e ka derdhur *cash* fillimisht në llogarinë e saj pranë “Credins Bank” dhe më pas, në datën 24.12.2021, e ka kaluar në llogari të shtetasit R. G., po pranë kësaj banke.

1.41. Në përfundim, subjekti deklaron se është bërë shlyerja totale e shumës së huas prej 30.000 euro dhe se shtetasi R. G., me deklaratën noteriale nr. ***, datë 21.1.2022, ka konfirmuar se huaja është shlyer plotësisht në 4 këste dhe subjekti nuk ka më asnjë detyrim ndaj tij⁴⁵.

⁴⁵Për të mbështetur deklaratimet e saj, në cilësinë e provës, subjekti paraqiti: veprim bankar, datë 11.6.2021, pranë BKT-së; faturë e thjeshtë tatimore nr. ***, datë 11.6.2021; veprim bankar, datë 11.6.2021, pranë “Credins Bank”; deklaratë noteriale nr. ***, datë 22.6.2021; veprim bankar, datë 22.6.2021, pranë BKT-së, veprim bankar, datë 25.6.2021, pranë “Credins Bank”, vendimi nr. ***, datë 9.9.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; deklaratë noteriale nr. ***, datë 22.10.2021, gjendja e datës 20.10.2021 për llogarinë e depozitës me afat për NRP disaemërore nr. ***, datë 7.9.2019 pranë “Credins Bank”; gjendja e datës 20.10.2021 për llogarinë e depozitës plus pranë “Credins Bank” nr. ***, datë 7.9.2019, në emër të shtetasit B. H.; 4 veprime bankare, datë 22.10.2021, pranë “Credins Bank”; 2 veprime bankare, datë 25.10.2021, pranë “Credins Bank”; deklaratë noteriale nr. ***, datë 18.11.2021; 2 veprime bankare, datë 24.12.2021, pranë “Credins Bank”; deklaratë noteriale nr. ***, datë 21.1.2021.

1.42. Nga hetimi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës⁴⁶ dhe asaj Kukës⁴⁷, si dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë⁴⁸, nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit me huadhënësin R. G. dhe shoqëritë e administruara prej tij.

1.43. Në përfundim, lidhur me burimin e parë (huaja nga shtetasi R. G.), Komisioni konstaton se huadhënësi ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huas në vlerën 30.000 euro.

ii. Kredi bankare në Bankën Kombëtare Tregtare në shumën 4.200.000 lekë

1.44. Në deklaratën *Vetting* dhe në DIPP/2015 subjekti ka deklaruar kredinë e marrë në Bankën Kombëtare Tregtare me kontratën nr. ***, datë 19.6.2015, në shumën 4.200.000 lekë, me qëllim likuidimin e vlerës së mbetur për blerjen e apartamentit. Palët e mësipërme kanë lidhur kontratën e hipotekimit nr. ***, datë 19.6.2015, sipas së cilës pasuria apartament me sip. 104,02 m² do të vendoset në hipotekë në favor të kreditorit BKT për të siguruar kthimin e kredisë së marrë. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga BKT-ja, me nr. *** prot., sipas të cilit deri në datën 20.1.2017 rezulton shuma e mbetur e papaguar e kredisë në vlerën 4.036.252 lekë, bashkëlidhur aneksi i planit të pagesave të kryera.

1.45. Referuar dokumentacionit të administruar nga BKT-ja⁴⁹ konfirmohet kredia hipotekore e marrë nga subjekti i rivlerësimit në shumën 4.200.000 lekë.

1.46. Komisioni konstaton se në datën 29.6.2015 është kryer lëvrimi i kredisë në vlerën 4.200.000 lekë. Në datën 30.6.2015 është transferuar në favor të noterës A. Ç. vlera 4.212.000 lekë, me përshkrimin “sa kaluar në llogarinë e noterës A. Ç. për shitësin ‘***’ sh.p.k., vlera e mbetur për blerje apartamenti sipas kontratës nr. ***, datë 3.6.2015, në shumën 30.000 euro (4.200.000 lekë me kurs 140.4)”.

1.47. Lidhur me shlyerjen e kredisë, vërehet se gjatë vitit 2015 është shlyer vlera 133.636 lekë (principal dhe interesa) dhe gjatë vitit 2016 është shlyer vlera 267.272 lekë (principal dhe interesa). Lidhur me burimin e dytë (kredia në BKT) nuk konstatohen problematika të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

1.48. Në konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin se ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie dhe nuk konstatohen problematika të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

2. Garazh me sip. 23 m², në rrugën “*”, Tiranë, në vlerën 4.000 euro**

2.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron garazh me sip. 23,00 m², me adresë rruga “***”, pallati përballë ***, me nr. ***, blerë nga shoqëria “***” sh.p.k., me kontratë shitjeje me rezervë pronësie nr. ***, datë 3.6.2015, notere publike A. Ç., regjistruar pranë ZVRPP-së Tiranë me nr. pasurie ***, z. k. ***, pajisur me certifikatë për vërtetim pronësie datë 9.6.2015. Vlera: 4.000 euro. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i krijimit: kredi bankare në BKT

⁴⁶Shkresë nr. *** prot., datë 7.11.2022.

⁴⁷Shkresë nr. *** prot., datë 3.11.2022.

⁴⁸Shkresë nr. *** prot., datë 8.11.2022.

⁴⁹Shkresë nr. *** prot., datë 27.7.2020.

në vlerën 4.200.000 lekë dhe hua në vlerën 30.000 euro nga huadhënësi R. G. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁵⁰.

2.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se në DIPP/2015 subjekti ka deklaruar të njëjtën sa deklaroi në deklaratën *Vetting* lidhur me pasurinë garazh të blerë në shumën 4.000 euro. Sikundër u trajtua më lart, sipas kontratës së shitjes së pasurisë me rezervë nr. ***, datë 3.6.2015, subjekti ka blerë nga pala shitëse, shoqëria “***” sh.p.k., garazhin me sip. 23 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me adresë rruga “****” përballë ***, k. ***, ap. ***, shk. ***, Tiranë, në vlerën 4.000 euro.

Sipas kontratës, shuma 30.000 euro do të paguhet menjëherë me nënshkrimin e saj dhe me pagesën e kësaj shume konsiderohet i likuiduar çmimi i pasurisë së paluajtshme garazh dhe pjesërisht çmimi i apartamentit. Blerësit i është vënë në dispozicion kjo pasuri përpara nënshkrimit të kësaj kontrate, pranuar dhe marrë në dorëzim pa rezervë. Në deklaratën *Vetting* dhe në DIPP/2015 subjekti ka deklaruar huan e marrë nga shtetasi R. G. në shumën 30.000 euro, me anë të kontratës së huas nr. ***, datë 2.6.2015. Në kontratë specifikohet se shuma 30.000 euro ka kaluar me anë të transfertës së kryer në BKT, në datën 3.6.2015, nga llogaria e huadhënësit në llogari të noteres publike A. Ç.. Sa rezulton se burimi i krijimit të kësaj pasurie është huaja e marrë nga shtetasi R. G., trajtuar më sipër.

2.3. Sipas certifikatës së pronësisë nr. ***, lëshuar në datën 12.5.2015, pasuria e llojit “garazh” me sip. 23 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, është e regjistruar në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k. Më tej, kjo pasuri ka kaluar në pronësi të subjektit, vërtetuar me certifikatën e pronësisë nr. ***, datë 9.6.2015.

2.4. Referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK Drejtoria Vendore Tiranë⁵¹, konfirmohet se në emër të subjektit të rivlerësimit Selvie Gjoçaj rezulton e regjistruar pasuria e llojit “garazh” me sip. 23 m², me nr. ***, z. k. ***⁵², vol. ***, f. ***.

2.5. Në konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin se ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie dhe nuk konstatohen problematika të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

3. Automjet tip “Opel Astra”, viti i prodhimit 2002, në vlerën 700 euro

3.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti deklaroi se ka në pronësi automjetin tip “Opel Astra”, viti i prodhimit 2002, blerë me kontratën për shitje komisionare nr. ***, datë 28.10.2013, shitës E. I., blerës Selvie Gjeçaj, redaktuar nga komisioner “****” sh.p.k. Prizren, Kosovë, regjistruar pranë DRSHTRR-së Durrës, me targa ***. Vlera: 700 euro. Pjesa takuese: 100%. Nuk deklarohet

⁵⁰Kontratë shitjeje pasurie me rezervë nr. ***, datë 3.6.2015; certifikatë për vërtetim nr. ***, lëshuar në datën 12.5.2015; kartelë e pasurisë së paluajtshme planrilevimi e pasurisë; prokurë e përgjithshme datë 24.9.2010, leje zhvillimi ndërtimi datë 8.11.2013 për shoqërinë “****” sh.p.k.; transferim nga llogaria në BKT, datë 3.6.2015, deklaratë noteriale nr. ***, datë 3.6.2015, certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***; kartelë pasurie nr. ***, kontratë huaje nr. ***, datë 2.6.2015; deklaratë datë 18.10.2016, e shtetasit R. G..

⁵¹Shkresë nr. ***prot., datë 30.9.2020.

⁵²Vërtetuar gjithashtu sipas dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, ZVRPP Tiranë, shkresa nr. *** prot., datë 12.12.2017.

burimi i krijimit. Për vërtetimin e deklarimeve të saj, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues⁵³.

3.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se në DIPP/2013 subjekti deklaroi automjet tip “Opel Astra”, viti i prodhimit 2002, blerë në Kosovë në vlerën 700 euro, taksa e regjistrimit, siguracioni etj., në shumën 60.000 (pesëdhjetë mijë)⁵⁴ lekë.

3.3. Referuar informacionit të përcjellë nga DRSHTRR-ja⁵⁵ rezultoi se në emër të subjektit është i regjistruar automjeti me targa ***. Ky automjet është blerë me kontratën për shitje komisionare nr. ***, lidhur në datën 28.10.2013, me palë shitëse “****” sh.p.k. dhe shtetasi E. I, rezident në Kosovë, palë blerëse subjekti Selvie Gjoçaj, me çmim 710 euro. Sipas deklaratës doganore datë 28.10.2013, mjete i zhdoganuar nga subjekti i rivlerësimit ka kushtuar në vlerën 710 euro (kursi i këmbimit 141,37 lekë) dhe shpenzimet doganore në shumën 31.561 lekë, në total 131.934 lekë.

3.4. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1, i kërkoi subjektit të deklarojë burimin e krijimit të kësaj pasurie, ku në përgjigje subjekti deklaroi se burimi i krijimit janë të ardhurat nga paga si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Këtë automjet e ka blerë nga shtetasi E. I., i cili është bashkëshorti i motrës së subjektit (në atë kohë motra me kunatin jetonin në Kosovë, pasi punonin atje dhe në fund të tetorit 2013 janë shpërngulur dhe subjekti ka vendosur ta blejë këtë automjet).

3.5. Më tej, Komisioni kreu analizën financiare për të ardhurat, pasuritë dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit për periudhën 1.1.2013 – 28.10.2013, nga ku rezultoi një balancë pozitive në vlerën 479.197 lekë.

3.6. Lidhur me aspektin deklarativ – deklarimi i subjektit në DIPP/2013 dhe në deklaratën *Vetting* nuk është në përputhje me detyrimin e përcaktuar në shtojcën nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pikën 7 të udhëzimit nr. *** prot., datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, pasi subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të këtij automjeti.

3.7. Komisioni vëren se kjo pasaktësi e konstatuar nuk përbën shkak të veçuar për të ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore, për sa kohë nuk ka rezultuar asnjë e dhënë tjetër që të mund të vinte në dyshim deklaratën e subjektit, si dhe nuk u konstatuan problematika të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016. Mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, kjo pasaktësi në deklarim nuk mund të kualifikohet në asnjë prej situatave të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe të përbëjnë, për pasojë, shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

3.8. Në konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie dhe nuk konstatohen problematika të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

⁵³Kontratë për shitje komisionare nr. ***, lidhur në datën 28.10.2013, leja e qarkullimit rrugor, deklarata doganore datë 28.10.2022, certifikatë pronësie e mjetit.

⁵⁴Deklaruar gabim nga ana e subjektit pasi nuk përputhet vlera e shënuar në shifra me atë në fjalë.

⁵⁵Shkresë nr. *** prot., datë 21.7.2020.

4. Llogari page pranë Bankës Kombëtare Tregtare në vlerën 348,55 lekë

4.1. Në deklaratën *Vetting* 2017 subjekti i rivlerësimit deklaroi gjendje në llogari page në BKT, në vlerën 348,55 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga.

4.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se BKT-ja⁵⁶ konfirmon llogarinë e deklaruar nga subjekti dhe se gjendja e saj në datën 26.1.2017 ka qenë në vlerën 348,55 lekë.

4.3. Komisioni konstaton se kreditimet në këtë llogari vijnë nga pagat.

4.4. Në konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në përputhje me ligjin dhe se ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie.

5. Lidhur me adresat e banimit

5.1. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës në vitin 2006, subjekti deklaroi si adresë të gjendjes civile Rajonin nr. ***, Durrës dhe adresë banimi Lagjen nr. ***, shtëpi private Durrës. Në DIPP/2006 subjekti deklaroi gjendjen civile dhe adresë banimi Rajonin nr. ***, Lagja nr. ***, shtëpi private Durrës. Në DIPP-të e viteve 2007 dhe 2008, subjekti deklaroi si adresë të gjendjes civile Lagjen nr. ***, Durrës dhe si adresë banimi Lagjen nr. ***, pallati tek ***, Kukës. Në DIPP/2009, subjekti deklaroi si adresë të gjendjes civile Lagjen nr. ***, Durrës dhe si adresë banimi Lagjen nr. ***, pallati ***, Kukës. Në DIPP/2010, subjekti deklaroi si adresë të gjendjes civile Lagjen nr. ***, Durrës dhe si adresë banimi banesën me qira pranë Prefekturës, Kukës. Në DIPP/2011, subjekti deklaroi si adresë të gjendjes civile Lagjen nr. ***, Durrës. Në DIPP/2012, subjekti deklaroi se për periudhën 1.9.2012 – 31.12.2012 banon me qira në Lagjen nr. ***, Kukës. Në total, shuma e qirasë 40.000 lekë. Në DIPP/2013 subjekti deklaroi se për periudhën janar - qershor 2013 banon me qira në Kukës, në banesën e qiradhënës H. D. F. (kontratë verbale). Në total, shuma e qirasë 60.000 lekë. Në DIPP/2014 nuk deklarohet adresë banimi. Në DIPP-të e viteve 2015 dhe 2016 subjekti deklaroi si adresë të gjendjes civile Lagjen nr. ***, Durrës dhe si adresë banimi rrugën “****”, pallati “****”, përballë ***, hyrja ***, kati ***, ap. ***, Tiranë. Në DIPP/2016 subjekti ka deklaruar si adresë Lagjen nr. ***, Durrës dhe si adresë banimi rrugën “****”, pallati “****”, përballë ***, hyrja ***, kati ***, ap. ***, Tiranë. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si adresë Lagjen nr. ***, Durrës dhe si adresë banimi rrugën “****”, pallati “****”, përballë ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë.

5.2. Në pyetësin standard deklaroi se ka banuar në adresat si vijon:

i. Në periudhën e stazhit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (tetor 2006 – korrik 2007) ka jetuar në qytetin e Durrësit të xhaxhai i nënës, z. A. L., i cili ka qenë pronar i objektit me adresë: Rajoni nr. ***, Lagja nr. ***, rruga “****”, banesa nr. ***, Durrës. Subjekti deklaroi se ka jetuar pa qira dhe nuk ka pasur ndonjë dokument me shkrim.

ii. Pas marrjes së emërimit si gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës prej periudhës nëntor 2007 – prill 2010 ka jetuar në adresën: Lagja nr. ***, (tek ***), pallati nr. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, Kukës. Kjo pasuri ka qenë në pronësi të shtetasve F. dhe V. A.. Qiraja 8.000 lekë/muaj. Kontrata ka qenë verbale dhe pagesa e qirasë është bërë dorazi. Në cilësinë e provës, subjekti ka

⁵⁶Shkresë nr. *** prot., datë 27.7.2020.

paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 15.7.2020, të qiradhënësve, të cilët pohojnë sa më sipër deklarohet.

iii. Në periudhën prill 2010 – korrik 2011 ka jetuar me qira në një banesë private pranë Prefekturës Kukës, në pronësi të shtetasit J. C. Kontratë verbale me qira në vlerën 10.000 lekë/muaj. PAGESA është bërë dorazi pa dokument.

iv. Në periudhën korrik 2011 – janar 2013 ka jetuar në një apartament me shtetaset P. B. dhe E. G., në adresën: Lagjja nr. ***, pallati ***, kati ***, Kukës. Kjo banesë ishte marrë më përpara me qira nga shtetasja P. B. dhe secila paguante 5.000 lekë/muaj. PAGESA është bërë dorazi pa dokument.

v. Në periudhën janar - qershor 2013 ka jetuar me qira në një garsoniere, në pronësi të shtetasës H. F., pallati përballë hyrjes së lokal “****”, Kukës. Qiraja ka qenë në vlerën 10.000 lekë/muaj, pagesa është bërë me bankë, kontrata ka qenë verbale. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 10.10.2016, që provon këtë marrëdhënie.

vi. Nga koha kur ka filluar efektivisht detyrën si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, periudha nëntor 2007 deri në kohën që është transferuar si gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (nëntor 2013), ndonjë ditë të javës apo në fundjavë ka ndenjur edhe në Tiranë në adresën: rruga “****”, nd. ***, h. ***, Njësia Administrative Nr. ***, kodi postar ***, Tiranë. Ky objekt ishte në pronësi të shtetasve I. dhe E. I.. Në këtë adresë kanë jetuar me qira motrat e subjektit F., J. dhe F. Gj., të cilat kanë ndjekur studimet e larta në Universitetin e Tiranës, njëra pas tjetrës, në kohë të ndryshme.

vii. Pas transferimit si gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në periudhën nëntor 2013 – korrik 2015 ka jetuar me qira me motrat J. dhe F. Gj. dhe më vonë edhe vëllai S. Gj.. Nuk ka pasur kontratë me shkrim, vlera e qirasë ka qenë 20.000 lekë, të cilat janë paguar dorazi, pa dokument. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti deklaratën noteriale nr. ***, datë 20.7.2020, me deklarues qiradhënësit I. dhe E. I., që provon këtë marrëdhënie, si dhe certifikatën e pronësisë nr. ***, datë 2.10.2013, regjistruar në emër të shtetasve I. dhe E. I.

viii. Nga korriku i vitit 2015 e në vijim jeton në apartamentin me adresë: Njësia Administrative Nr. ***, rruga “****”, nd. ***, h. ***, ap. ***, kodi postar ***, Tiranë. Më 12.4.2019 ka lidhur martesë me shtetasin B. H. Nga kjo kohë e në vijim jetojnë së bashku në këtë adresë.

5.3. Duke qenë se në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës në vitin 2006, subjekti ka deklaruar si adresë të gjendjes civile *Rajoni nr. ***, Durrës* dhe në DIPP-të vijuese si adresë të gjendjes civile *Lagjja nr. ***, Durrës*. Me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkua të japë shpjegime se kujt i përkiste kjo adresë në vitet që është deklaruar si adresë e gjendjes civile dhe periudhat kur subjekti ka banuar aty.

5.4. Në përgjigje, subjekti deklaroi se këto adresa janë sipas gjendjes civile. Ka qenë e regjistruar si banore e Rajonit nr. ***, Lagjja nr. ***, Durrës. Nuk ka pasur shtëpi dhe nuk ka jetuar në këtë adresë. E vetmja shtëpi që ka pasur dhe ka që nga qershori i vitit 2015 është ajo e ndodhur në adresën: rruga “****”, nd. ***, h. ***, ap. ***, Njësia Administrative Nr. ***, kodi postar ***, Tiranë. Në korrik të vitit 2017 është shpërngulur dhe vendosur si banore e Njësisë Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë. Ndërkohë, nga koha kur ka marrë për herë të parë detyrën, tetor 2006 e

deri në qershor 2015, ka qëndruar në adresa të ndryshme (vendqëndrime), kushtëzuar nga vendi ku ushtronte detyrën.

5.5. Komisioni ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile lidhur me adresën e gjendjes civile aktuale të subjektit dhe ndryshimet e pësuara ndër vite. Pas administrimit të shkresës nr. ***prot., datë 8.11.2022, rezulton se subjekti i rivlerësimit fillimisht ka qenë e regjistruar në Njësinë Administrative ***, Bashkia Tropojë. Në datën 11.6.1996 ka ndryshuar vendbanimin në Bashkinë Durrës, Rajoni nr. **. Në datën 24.7.2017 figuron e regjistruar banore në Njësinë Administrative Nr. **, Bashkia Tiranë, me adresë banimi: rruga “****”, nd. **, h. **, ap. **.

5.6. Me anë të pyetësorit nr. 2⁵⁷ subjektit iu kërkuar të deklarojë se ku ka jetuar gjatë kohës që ka ndjekur Shkollën e Magjistraturës (tetor 2004 – tetor 2006). Në përgjigje⁵⁸, subjekti deklaroi se gjatë kësaj periudhe gjendjen civile e ka pasur në Lagjen nr. **, Durrës dhe ka jetuar me qira në adresën: bulevardi “****”, p. **, k. **, ap. **, Tiranë. Në këtë adresë jetonte bashkë me shoqen e saj E. D. (S.) dhe motrën e kësaj të fundit E. S. (S.), të cilat ishin vendosur më parë me qira në këtë banesë dhe nuk kishin lidhur një kontratë qiraje me shkrim, pra kontrata ka qenë verbale. Qiraja ka qenë në vlerën 20.000 lekë/muaj dhe subjekti paguante 1/3 e kësaj shume. Shtëpia ka qenë në pronësi të shtetasve P. dhe K. D., të cilët në atë kohë jetonin jashtë shtetit dhe kishin lënë si person kontakti për marrjen e qirasë mujore shtetasen E. D. Subjekti deklaroi se nuk disponon ndonjë dokument për të vërtetuar këtë marrëdhënie, pasi kontrata e qirasë ka qenë verbale dhe se kontaktet me qiradhënësin (personin përgjegjës të zgjedhur prej tij) i ka mbajtur shoqja e saj E. D. (S.).

5.7. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoj shpjegime subjektit shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues, lidhur me konstatimin se: *Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti nuk është deklaruar se kujt i përket adresa e regjistrimit të gjendjes civile “Rajoni nr. **, Lagjia nr. **, **, Durrës”.*

5.8. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim deklaroi se fillimisht ka qenë i regjistruar si banor në Njësinë Administrative ***, Bashkia Tropojë, në përbërje familjare me prindërit, gjyshen (në atë kohë gjallë) dhe motrat. Në datën 11.6.1996, prindërit ndryshuan regjistrimin, duke u vendosur në Bashkinë Durrës, Rajoni nr. **, Lagjia nr. **, kohë në të cilën subjekti vazhdonte shkollën e mesme në Elbasan dhe ende nuk kishte mbushur moshën 18 vjeç.

Për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, nuk ka arritur të sigurojë informacion dhe/ose dokumentacion mbi bazën e të cilit është bërë regjistrimi nga babai i subjektit në Bashkinë Durrës, Rajoni nr. **, Lagjia nr. **. Me anë të shkresës nr. *** prot., datë 7.2.2023, Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Nr. **, Durrës, ka informuar se: *“Në periudhën e kërkuar, veprimet për ndryshimin e vendbanimit, transferimit familjar të shtetasve kryheshin në bazë të legjislacionit të aplikueshëm të kohës⁵⁹. Për ndryshimin e vendbanimit të familjes Gjoçaj, që dokumentohet sipas të dhënave në regjistrin themeltar të regjistrimit të popullsisë së vitit 1974, me referencë **, për*

⁵⁷Email datë 23.1.2023, ora 10:41.

⁵⁸Dokumentacioni i protokolluar në Komision me nr. **, datë 26.1.2023 dhe email datë 26.1.2023, ora 14:40.

⁵⁹Vendimi nr. 14, datë 24.1.1994, i Këshillit të Ministrave “Për ndryshimin e vendbanimit nga shtetasit shqiptarë”.

*periudhën e kërkuar në vitin 1996 nuk administrohen dokumentet përkatëse (komunikimi respektiv me zyrën e gjendjes civile në ish-Komunën ***, Bashkia Tropojë)”. Në përfundim, subjekti deklaroi se as babai i saj nuk disponon ndonjë dokument në lidhje me regjistrimin në këtë adresë. Pavarësisht se kanë qenë të regjistruar në gjendjen civile, Rajoni nr. ***, Lagjja nr. *** Durrës, faktikisht asnjëri prej tyre nuk jetonte aty. Në datën 5.4.2005, prindërit, motrat dhe vëllai i subjektit, që vijonin të ishin pjesë e përbërjes familjare, kanë transferuar (rikthyer) sërish gjendjen civile në fshatin ***, Tropojë, ndërkohë që subjekti ka mbetur e vetme në trung në Lagjen nr. ***, Durrës (regjistër themeltar i vitit 1974, ***). Pra, kjo mbeti adresa në vijim, adresë të cilën e ka deklaruar në deklaratën përpara fillimit të detyrës dhe në deklaratat periodike vjetore, derisa në korrik të vitit 2017 është shpërngulur dhe vendosur si banore e Njësisë Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë.*

Arsyetimi ligjor në lidhje me ligjin e zbatueshëm

5.9. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

5.10. Nga analizimi i shkresës nr. *** prot., datë 7.2.2023, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Njësia Administrative Nr. ***, Bashkia Durrës, të paraqitur në cilësinë e provës së bashku me parashtrimet, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, rezulton se të gjithë pjesëtarët e familjes së subjektit (gjithsej 12 persona) janë shkëputur nga gjendja civile Rajoni nr. ***, Lagjja nr. ***, Durrës, në datën 5.4.2005, duke u transferuar në njësinë ***, Tropojë, me përjashtim të subjektit të rivlerësimit Selvie Gjoçaj, e cila nuk rezulton të jetë transferuar dhe, për pasojë, ka qëndruar më vete si kryefamiljare⁶⁰. Gjatë hetimit nuk u provua që subjekti apo familjarët të zotërojnë pasuri apo të kenë banuar në këtë adresë, çka krijon bindjen se deklaratimet dhe provat e paraqitura nga subjekti janë shteruese.

Në konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se lidhur me deklarin e kësaj adrese nuk konstatohen problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

6. Gjendja e likuiditeteve cash

6.1. Në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* jashtë sistemit bankar.

6.2. Ndër vite subjekti ka deklaruar: (i) në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës në vitin 2006, gjendjen *cash* në shumën 800.000 lekë; (ii) në DIPP/2006, gjendjen *cash* në shumën 150.000 lekë; (iii) në DIPP-të vijuese nuk janë deklaruar shtesa apo pakësime.

6.3. Me anë të pyetësorit nr. 1 subjektit iu kërkua të deklaronte burimin e krijimit të këtyre vlerave, si dhe gjendjen e këtyre likuiditeteve në fund të vitit 2006, në vitet në vijim dhe në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*. Në përgjigje, subjekti deklaroi se: (i) shuma 800.000 lekë është

⁶⁰Sipas fletës së regjistrimit themeltar nr. ***, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile ***, Njësia Administrative Durrës ***, Bashkia Durrës.

krijuar me të ardhurat nga puna, përpara se të fillonte Shkollën e Magjistraturës, konkretisht, puna si asistente zyre pranë zyrës ligjore të avokatit M. M., për periudhën janar 2002 – shtator 2004, si dhe bursa që ka marrë nga Shkolla e Magjistraturës gjatë kohës që ishte studente; (ii) shuma 150.000 lekë është krijuar me të ardhurat nga paga deri më 31.12.2006. Më tej, sqaroi se gjendja e likuiditeteve jashtë sistemit bankar në vitin 2006 ka qenë në vlerën 150.000 lekë. Kjo shumë është pakësuar në vitet në vijim, duke u shpenzuar për nevoja të përditshme, por nuk mban mend kur, si dhe nuk ka pasur likuiditete të tjera jashtë sistemit bankar në vijim dhe as në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*.

6.4. Për të mbështetur deklaratimet e saj, në cilësinë e provës, subjekti paraqiti *statement* bankar, datë 7.11.2022, tërhequr pranë “Raiffeisen Bank”, si dhe deklaratën noteriale nr. ***, datë 23.1.2017, me deklaruës shtetasin M. M.. Në këtë deklaratë, shtetasi M. M. deklaroi se ushtron profesionin e avokatit, i regjistruar si person fizik në datën 14.11.1996, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe se subjekti i rivlerësimit ka punuar pranë tij si asistente zyre për periudhën janar 2002 – shtator 2004, me një pagë mujore prej 25.000 lekësh. Gjithashtu, ky shtetas deklaroi se në këtë periudhë kohe ka qenë President i Federatës Shqiptare të *** dhe se subjekti ka realizuar përkthime materiale në gjuhë të huaja (anglisht dhe frëngjisht).

6.5. Më tej, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 8.11.2022, me deklaruës z. M. M., i cili deklaroi sa më sipër, si dhe se pas muajit shtator 2004 deri në shtator 2006, pavarësisht se subjekti kishte shkëputur marrëdhëniet e punës pranë zyrës së tij, ka marrë pjesë bashkë me të në disa aktivitete të zhvilluara nga Federata Evropiane e *** dhe Federata Ndërkombëtare e ***, ku ajo ka përkthyer pa pagesë.

6.6. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e mësipërme, konstaton se deklarata noteriale e paraqitur nga subjekti për punësimin e saj pranë zyrës së avokatisë të z. M. M., nuk provon se për këto të ardhura janë paguar detyrimet tatimore dhe, për rrjedhojë, nuk plotësojnë kriterin e parashikuar nga pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës⁶¹, që shprehimisht parashikon pagimin e detyrimeve tatimore si element të ligjshmërisë.

Gjithashtu, nga hetimi rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* përfitimin e këtyre të ardhurave sipas parashikimeve të pikës 19, neni 3 i ligjit nr. 84/2016.

6.7. Lidhur me deklaratimet e subjektit për likuiditetet *cash*, Komisioni vëren se ato nuk janë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003, ku, referuar nenit 4, germa “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, parashikohet se subjektet detyrohen të deklarojnë *vlerën e likuiditeteve, gjendjen cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj*, si dhe referuar nenit 7, pika 1 e ligjit më sipër, *në deklarin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë [...]*. Megjithatë, duke iu referuar mënyrës së deklarinimit të subjektit në DIPP/2006, duket se ai ka deklaruar gjendjen e likuiditeteve *cash* në fund të vitit kalendarik.

⁶¹ “[...] Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore”.

6.8. Për rrjedhojë të sa më lart, Komisioni vëren se subjekti nuk ka dhënë shpjegime lidhur me shpenzimin e shumës prej 800.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës në vitin 2006.

6.9. Për të verifikuar burimet e ligjshme të krijimit të kursimeve në vlerën 800.000 lekë, të deklaruara në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2006, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.10.2004⁶² – 4.10.2006⁶³, pasi vetëm për këtë periudhë disponohej dokumentacion lidhur me të ardhurat e subjektit. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se subjekti ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 331.562 lekë për krijimin e kursimeve në vlerën 800.000 lekë.

6.10. Më tej, Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar burimet e ligjshme të krijimit të kursimeve prej 150.000 lekësh, të deklaruara në DIPP/2006, shumë e cila sipas deklaramit të subjektit është krijuar me të ardhurat nga paga deri më 31.12.2006, nga ku rezultoi se subjekti ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e kursimeve në vlerën 150.000 lekë⁶⁴.

6.11. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimin se: *Subjekti ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 331.562 lekë për krijimin e kursimeve në vlerën 800.000 lekë të deklaruara në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2006.*

6.12. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se Komisioni në analizën e kryer për periudhën përpara fillimit të detyrës ka përlllogaritur vetëm të ardhurat nga bursa në Shkollën e Magjistraturës. Gjatë periudhës janar 2002 – shtator 2004 subjekti deklaroi se ka punuar si asistente zyre pranë zyrës ligjore të av. M. M. dhe ka përfituar *cash* pagën në masën 25.000 lekë/muaj, duke qenë se në atë kohë sistemi bankar nuk ishte i konsoliduar dhe pagat nuk kalonin me transfertë bankare, por *cash*. Gjithashtu, subjekti pretendon se ka realizuar të ardhura edhe nga përkthimet në aktivitete të Federatës Shqiptare të ***.

Sa i takon vlerësimit të ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, në kuadër të standardit të vendosur nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, subjekti deklaroi se detyrimet tatimore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi bien mbi palën punëdhënëse dhe se nuk mund të penalizohet në kuadër të procesit të rivlerësimit, pasi në moshë tepër të re në atë kohë nuk ka qenë në dijeni të mospërmbushjes dhe mospagesës së detyrimeve nga punëdhënësi.

6.13. Më tej, subjekti deklaroi se ashtu si Komisioni ka konstatuar, këto të ardhura nuk kanë shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie. Analiza financiare e kryer nga Komisioni për krijimin e likuiditetit *cash* në shumën 150.000 në fund të vitit 2006, rezultoi pozitive në vlerën 798.433 lekë. Pra, edhe sikur të zbritet diferenca e pambuluar sipas analizës së kryer nga Komisioni, përsëri balanca në fund të vitit 2006 rezultoi në vlera të konsiderueshme pozitive. Nga ana tjetër, e vetmja diferencë tjetër negative që Komisioni ka konstatuar për periudhën nga fillimi i detyrës deri në

⁶²Fillimi i Shkollës së Magjistraturës.

⁶³Përpara emërimit.

⁶⁴Analiza financiare për periudhën 5.10.2006 – 31.12.2006.

vitin 2016 është ajo në vitin 2015, në shumën 19.044 lekë, pra në një vlerë shumë të vogël dhe se trupat gjyqësorë të rivlerësimit kanë vendosur disa standarde sa i përket parimit të proporcionalitetit. Gjithashtu, GJEDNJ-ja ka konsideruar se jo çdo mospërputhje në deklaratat e pasurisë ose mospërputhje të parëndësishme ndërmjet shpenzimeve dhe burimeve të ligjshme duhet të passjellë masën më të rëndë disiplinore, atë të shkarkimit nga detyra (shihni S., 85).

Arsyetimi ligjor në lidhje me ligjin e zbatueshëm

6.14. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

6.15. Subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument ligjor provues lidhur me të ardhurat e pretenduara në masën 25.000 lekë/muaj, nga punësimi pranë zyrës ligjore të shtetasit M. M., si dhe të ardhurat e realizuara nga përkthimet në aktivitete të Federatës Shqiptare të ***. Për sa kohë subjekti dështoi të provojë burimet e ligjshme të krijimit të këtyre të ardhurave dhe për sa kohë për këto të ardhura nuk janë paguar detyrimet tatimore, duke plotësuar kriterin e parashikuar nga pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës⁶⁵, Komisioni nuk i mori parasysh në analizën financiare.

Për rrjedhojë, mbetet i pandryshuar konkluzioni se subjekti rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 331.562 lekë për krijimin e kursimeve në vlerën 800.000 lekë, të deklaruara në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës në vitin 2006.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, balanca negative në vlerën 331.562 lekë nuk mund të kualifikohet në asnjë prej situatave të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe të përbëjë, për pasojë, shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

7. Hetime të tjera

7.1. Nga hetimi i Komisionit referuar informacionit të administruar nga ASHK-ja⁶⁶ rezulton se babai i subjektit, z. M. Gj., është aplikues në procesin e legalizimit në Qarkun Durrës, sipas formularit A me nr. ***, datë 13.11.2006 dhe është pajisur me leje legalizimi nr. ***, datë 19.3.2013, për godinën e banimit 1-katëshe në Durrës.

7.2. Me anë të pyetësorit nr. 1, Komisioni kërkoi nga subjekti të deklarojë adresën e saktë të këtij objekti, periudhën gjatë së cilës është ndërtuar ky objekt, koston dhe burimin e krijimit të të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e tij. Në përgjigje, subjekti deklaroi se adresa e saktë e këtij objekti është: “*Njësia Administrative Nr. ***, Lagja nr. ***, rruga ‘***’, banesë private nr. ***, ***, Durrës*”. Ky objekt është ndërtuar i shtrirë në kohë për periudhën 2005 – 2009.

⁶⁵ “[...] Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore”.

⁶⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 26.8.2020.

Ndërtimi ka qenë informal, në tokë shtetërore, *** Durrës dhe është deklaruar për legalizim nga babai M. Gj.

7.3. Subjekti deklaron se shpenzimet për ndërtimin e kësaj banese janë mbuluar nga prindërit dhe fëmijët madhorë sipas certifikatës. Burimi kryesor i krijimit të të ardhurave për ndërtim kanë qenë të ardhurat që ata siguronin nga bujqësia, blegtoria dhe të ardhurat që siguronin gjatë verës nga shitja e bimëve medicinale që i mblidhnin në bjeshkët e Tropojës. Motra e subjektit Sh. Gj. ka jetuar me prindërit deri në kohën kur është martuar në tetor 2008 dhe ka qenë e punësuar si mësuese në gjimnazin “***”, në B. C., Tropojë. Ndërtimi është bërë i shtrirë në vite sipas mundësisë. Është shpenzuar vetëm për materialet e ndërtimit, ndërsa shpenzime për fuqi punëtore nuk ka pasur, pasi babai i subjektit ka punuar vetë si usta, i ndihmuar edhe nga të afërmit. Materialet janë siguruar në treg të lirë dhe të cilësisë deri diku mesatare sepse kjo ka qenë mundësia e tyre. Kostoja totale e ndërtimit ka shkuar 2.000.000 lekë.

7.4. Ky objekt është legalizuar në vitin 2013, kostot e legalizimit në shumën 1.076.150 lekë janë mbuluar nga prindërit dhe motrat me burim krijimi të ardhurat që kanë siguruar çdo vit gjatë verës nga shitja e bimëve medicinale. Ndihmesë ka dhënë edhe motra F. I. (Gj.) me të ardhurat e saj nga punësimi pranë shoqërisë “***” për periudhën 2011 – 2013. Në përfundim, subjekti sqaron se ka qenë e ndarë nga trangu familjar *de facto* që nga muaji shtator i vitit 1993 (kur ka filluar shkollën e mesme në Elbasan), ndërsa *de jure* prej muajit prill 2005 ka qenë e ndarë nga trangu familjar dhe ka jetuar gjithmonë më vete dhe nga koha kur ka filluar për herë të parë detyrën e në vijim ka jetuar në adresat që ka deklaruar.

7.5. Me anë të pyetësorit nr. 2⁶⁷ subjektit iu kërkua të paraqesë dokument ligjor provues që vërteton ndarjen nga trangu familjar në periudhën e deklaruar, prill 2005. Në përgjigje⁶⁸, subjekti deklaroi se: *“Ashtu siç kam deklaruar edhe më parë, unë jam shkëputur nga trangu familjar de fakto që nga muaji shtator i vitit 1993, kur kam filluar shkollën e mesme të gjuhëve të huaja në Elbasan. Në atë kohë unë kam qenë e mitur dhe në përbërje familjare me prindërit e mi, gjyshen dhe motrat, të gjithë banues në fshatin ***, Tropojë. Më pas, në datën 11.6.1996, kemi transferuar gjendjen civile në Lagjen nr. ***, Durrës. Në datën 5.4.2005, prindërit, motrat dhe vëllai (ato që vijonin të ishin pjesë e përbërjes familjare) kanë transferuar sërish gjendjen civile në fshatin ***, Tropojë, ndërkohë që unë kam mbetur trung më vete në Lagjen nr. ***, Durrës (regjistër themeltar i vitit 1974, ***). Nga kjo kohë e deri në vitin 2017, kam pasur gjendjen civile në Lagjen nr. ***, Durrës. Në këtë vit jam shpërngulur dhe vendosur si banore e Njësisë Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë, në zbatim edhe të parashikimeve ligjore të miratuara në atë kohë, sipas të cilave u bë e detyrueshme zhvendosja e gjendjes civile në zonën apo qytetin ku jetoj. Aktualisht, vijoj të jem banore e kësaj njësie. Pra, nga data 5.4.2005 e në vijim unë kam qenë dhe vijoj të jem në trung familjar më vete”*. Për të provuar deklaramet e saj, në cilësinë e provës, subjekti paraqiti: certifikatë të përbërjes familjare me nr. serie ***, lëshuar në datën 21.10.2022 nga Zyra e Gjendjes Civile ***, Njësia Administrative Durrës ***, Bashkia Durrës; fletë regjistri viti 1974, me nr. ***, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile ***, Njësia Administrative Durrës ***, Bashkia Durrës;

⁶⁷Email datë 23.1.2023, ora 10:41.

⁶⁸Dokumentacioni i protokolluar në Komision me nr. ***, datë 26.1.2023 dhe e-mail datë 26.1.2023, ora 14:40.

certifikatë familjare tërhequr në rrugë elektronike më 25.1.2023 nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë.

7.6. Nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur Komisioni vëren se sipas fletës së regjistrit themeltar nr. ***, të gjithë pjesëtarët e familjes së subjektit (gjithsej 12 persona) janë shkëputur në datën 5.4.2005, duke u transferuar në njësinë ***, Tropojë, me përjashtim të subjektit të rivlerësimit Selvie Gjoçaj, e cila nuk rezulton të jetë transferuar dhe, për pasojë, ka qëndruar më vete si kryefamiljare.

7.7. Më tej, me anë të pyetësorit nr. 2⁶⁹, subjektit iu kërkua të paraqesë foto të objektit të legalizuar, si dhe foto të gjendjes së objektit në momentin e aplikimit për leje legalizimi.

7.8. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti 12 foto, ku pasqyrohet gjendja e objektit në datën 24.1.2023 (pamje nga brenda dhe jashtë objektit), nga ku rezulton se është një shtëpi banimi 1-katëshe. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur formularin e vetëdeklarimit për legalizim objekti nr. ***, datë 13.11.2006, me vetëdeklarues shtetasin M. B. Gj., bashkëlidhur 4 foto të realizuara në kohën e vetëdeklarimit (të printuar në një fletë formati A4), ku vërehet se gjendja e objektit 1-katësh në këtë kohë ka qenë në fazën e karabinasë. Në përfundim, subjekti deklaroi se këto dokumente janë pjesë e dosjes së legalizimit, një kopje e së cilës është tërhequr nga babai i saj pranë ASHK-së Durrës dhe se nuk disponojnë foto të tjera të kohës së aplikimit për legalizim të këtij objekti.

7.9. Sa më lart, Komisioni vëren se referuar formularit të vetëdeklarimit për legalizim, objekti është ndërtuar në janar të vitit 2006, periudhë në të cilën subjekti rezultonte i ndarë nga trangu familjar dhe ndiqte Shkollën e Magjistraturës në Tiranë. Në vitet në vijim (2007 – 2016) subjekti nuk ka banuar në qytetin e Durrësit (ku ndodhet objekti në fjalë), e provuar kjo nga deklaratimet e saj në DIPP-të vjetore.

7.10. Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni vlerëson se nuk u konstatuan problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

8. Analiza financiare

8.1. Komisioni kreu analizën financiare duke konsideruar pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e rivlerësimit për periudhën tetor 2004 – dhjetor 2016. Analiza financiare paraqitet e përmbledhur në vijim dhe e detajuar në aneks 01 – analiza financiare e detajuar dhe aneks 02 – metodika e analizës financiare.

Viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete cash	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime	Balanca negative në fund të vitit
1.10.2004 – 4.10.2006	0	800,000	74,081	936,090	0	393,572	-331,562	-331,562
5.10.2006- 31.12.2006	0	-650,000	15,913	191,735	0	27,389	798,433	0

⁶⁹Email datë 23.1.2023, ora 10:41.

2007	0	-150,000	68,074	788,763		190,072	680,617	0
2008	0	0	-103,248	803,510	0	312,073	594,685	0
2009	0	0	76,885	824,492	0	277,200	470,407	0
2010	0	0	60,434	820,892	0	250,620	509,838	0
2011	0	0	-37,714	870,631	0	271,568	636,777	0
2012	0	0	-9,867	942,975	0	267,830	685,011	0
2013	131,934	0	-136,829	923,547	0	253,643	674,799	0
2014	0	0	20,545	1,021,091	0	376,998	623,548	0
2015	8,455,800	0	-10,249	1,043,198	8,427,900	1,044,591	-19,044	-19,044
2016	0	0	-17,166	1,057,629	0	512,240	562,555	0
TOTAL	8,587,734	-	859	10,224,553	8,427,900	4,177,795	5,886,065	-350,606

Konkluzion i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

8.2. Në përfundim, pas analizimit të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë prapësimeve, rezultoi se subjekti ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 331.562 lekë, për krijimin e kursimeve në vlerën 800.000 lekë, të deklaruara në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2006.

8.3. Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, objektivitetit dhe duke vënë në balancë vlerën e pamjaftueshmërisë në shumën 331.562 lekë⁷⁰, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, vlerësohet se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të saj, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

8.4. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Selvie Gjoçaj ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

9. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 4.8.2020, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

10. Sipas këtij raporti: (a) subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës; (b) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Si konkluzion, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Selvie Gjoçaj.

⁷⁰Sikundër u trajtua edhe në pikën 6 të këtij vendimi.

11. Komisioni ka kërkuar përditësimin e raportit me materialet shtesë që mund të disponohen deri aktualisht. Sipas informacionit të vënë në dispozicion me anë të shkresës nr. *** prot., datë 31.5.2022, rezulton se nuk u administruan të dhëna shtesë lidhur me subjektin e rivlerësimit, çka nuk e ndryshon konstatimin e DSIK-së për përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës.

12. Bazuar në faktet e sipërpërmendura, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën e kontrollit të figurës sipas ligjit, nuk ka bërë deklaram të pasaktë, si dhe nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

13. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit Selvie Gjoçaj ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, duke konkluduar se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

14. Subjekti i rivlerësimit Selvie Gjoçaj ka marrë titullin “Jurist” pranë Universitetit të Tiranës në datën 2.7.2001 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” pranë Shkollës së Magjistraturës në vitin 2007. Me Dekretin nr. ***, datë 4.10.2006, të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtare dhe caktuar të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Më pas, me Dekretin nr. ***, datë 14.11.2007, të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, ndërsa me Dekretin nr. ***, datë 16.7.2013, është emëruar gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku aktualisht vazhdon të ushtrojë detyrën.

15. Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

16. Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka përgatitur një raport për vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit Selvie Gjoçaj. Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formulari i vetëvlerësimit dhe dokumentacioni i paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjet e vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në KLGJ.

Aftësitë profesionale

17. Njohuritë ligjore – nga dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ndër pesë dosjet e vëzhguara, janë ankimuar

4 prej tyre. Në tri raste vendimet janë lënë në fuqi nga shkalla e dytë e gjykimit, ndërsa në një rast është ndryshuar vendimi nga Gjykata Administrative e Apelit, duke ulur vlerën e shpërblimit për paditësin.

18. Arsyetimi ligjor – vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara nga subjekti i rivlerësimit përmbajnë strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural civil. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jep përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Subjekti i kushton gjithmonë rëndësi analizës së normës ligjore dhe arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, duke referuar bazën ligjore dhe shkakun ligjor.

Aftësitë organizative

19. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë – sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë për efekt të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 subjekti ka gjykuar gjithsej 1916 çështje gjyqësore administrative, nga të cilat 1158 për kundërshtim akti administrativ, 243 marrëdhënie pune dhe 515 kërkesa administrative.

20. Në interpretim të pikës 3, germa “c” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari administrativ i shkallës së parë duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 150 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative. Ky rregull nënkupton një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 450 gjykime çështjesh të tilla për 3 vjet. Nga të dhënat statistikore konstatohet lehtësisht se subjekti ka pasur ngarkesë sasiore shumë të lartë mbi standardin minimal.

21. Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve ka qenë në intervale kohore nga 1 muaj e 15 ditë deri në 2 muaj e 22 ditë. Njëra nga çështjet që ka pasur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit, 2 muaj e 22 ditë, ka qenë mosmarrëveshje në fushën e shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor, me afat 6 muaj, ku në përfundim të gjykimit është disponuar me vendim themeli.

22. Lidhur me afatet e gjykimit në mosmarrëveshjet administrative Komisioni vlerëson se referenca ligjore në Sistemin e Vlerësimit të Gjyqtarëve, Aneksi 1 “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, miratuar me vendim të KLD-së, daton në vitin 2010, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 49/2012 dhe referon në dispozitën e nenit 327⁷¹ të Kodit të Procedurës Civile. Më tej, me ndryshimet e bëra në Kodin e Procedurës Civile (ligji nr. 38/2017, datë 30.3.2017) në nenin 399/2 përcaktohen afatet e arsyeshme të gjykimit, si dhe kriteret që duhet të mbahen parasysh për të konkluduar nëse janë respektuar apo jo. Sa rezulton, bazuar në nenin 399/1, afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, do të konsiderohen në gjykimin administrativ në shkallën e parë dhe në apel përfundimi i gjykimit brenda një viti nga fillimi i tij në secilën shkallë.

⁷¹Padia kundër një akti administrativ shqyrtohet nga seksioni përkatës i gjykatës, në zonën e së cilës ka qendrën organi administrativ, ndaj të cilit drejtohet padia. Kur padia paraqitet në gjykatën, në territorin e së cilës ka qendrën organi administrativ, kjo ia dërgon jo më vonë se 3 ditë gjykatës, ku është krijuar seksioni për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. Shqyrtimi i mosmarrëveshjes duhet të përfundojë brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit në gjykatë.

23. Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara është konstatuar se subjekti i ka kushtuar rëndësi arsyetimit në kohën e duhur të vendimeve gjyqësore, brenda afatit ligjor 7-ditor, vetëm në një rast rezultoi të jetë dorëzuar me vonesë. Më konkretisht, për çështjen administrative me paditës A. L., të paditur ZQRPP Tiranë, ZVRPP Tiranë, me objekt “detyrim për dëmshpërblim për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës, etj.”, vendimi gjyqësor nr. *** është dhënë në datën 17.12.2014, ndërkohë që dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar janë depozituar në kryesekretari në datën 29.12.2014 – pas 12 ditëve nga shpallja, jashtë afatit 7-ditor të përcaktuar nga neni 42, pika 3 e ligjit nr. 49/2012.

24. Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e tij duke sqaruar se kjo vonesë ka ndodhur për shkak të ngarkesës së madhe në punë. Referuar të dhënave statistikore në vitin 2014, subjektit i janë caktuar 647 çështje, nga këto të përfunduara 580, nga ku rezulton të këtë qenë viti me ngarkesën më të madhe. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti fotokopje të kalendarit të seancave që ka pasur të planifikuara për gjykim gjatë periudhës 8 – 26.12.2014. Gjithashtu sqaron se kjo çështje është përfunduar në dhjetor të vitit 2014, periudhë e cila është shumë më e ngarkuar se pjesa tjetër e vitit, si dhe duhet pasur parasysh se në këtë afat është përfshirë edhe koha që i është dashur sekretares gjyqësore pasi është zbardhur vendimi për të kryer veprimet për qepjen, inventarizimin dhe dorëzimin e dosjes në sekretarinë e gjykatës.

25. Arsyetimi ligjor i Komisionit – vonesa me tejkallim prej 5 ditësh është e papërfillshme në këtë rast krahasuar me ngarkesën e subjektit, për pasojë, Komisioni vlerëson se kjo çështje nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

26. Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore – vlerësohet se subjekti i rivlerësimit ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa. Seancat e vëzhguara përgjithësisht janë çelur sipas planifikimit. Subjekti i ka vënë në lëvizje të gjitha çështjet gjyqësore administrative brenda afatit 7-ditor të parashikuar në nenin 25 të ligjit nr. 49/2012. Po kështu, ka vendosur dhe ka shtyrë seancën për shpalljen e arsyetuar të vendimit përfundimtar, brenda afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 42, pika 3 e ligjit nr. 49/2012.

27. Aftësia për të administruar dosjet – dokumentacioni në dosjet e vëzhguara paraqitet i rregullt, procesverbalet që dokumentojnë veprimet përgatitore apo seancat gjyqësore përgjithësisht janë të plota, duke dokumentuar palët pjesëmarrëse dhe veprimet e kryera sipas kërkesave të ligjit procedural.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

28. Etika në punë – sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, ndaj subjektit të rivlerësimit nuk rezulton ndonjë kërkesë për procedim disiplinor apo të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Nga analiza e të dhënave në dosjen personale të subjektit që disponohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit janë paraqitur në Inspektoratin e ish-KLD-së 6 ankesa (1 në vitin 2013, 4 në vitin 2014 dhe 1 në vitin 2015), 5 ankesa janë arkivuar, nga të cilat 4 (1 e vitit 2013, 2 të vitit 2014 dhe

1 e vitit 2015) janë arkivuar me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor dhe 1 ankesë e vitit 2014 është arkivuar si ankesë e përsëritur më parë, 1 ankesë e vitit 2014 e verifikuar për zvarritje i është regjistruar gjyqtarës për efekt vlerësimi profesional dhe etik.

29. Integriteti – referuar të dhënave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe dosjeve të vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

30. Paanësia – gjatë hetimit nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Selvie Gjoçaj. Në asnjë prej dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtim nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, në asnjë rast nuk është konstatuar të ketë pasur objekt gjykimi çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste ku subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

31. Aftësitë e komunikimit – në dosjet gjyqësore të vëzhguara konstatohet se subjekti i rivlerësimit komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Në të gjitha rastet, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

32. Gatishmëria për t'u angazhuar – subjekti i rivlerësimit i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 10 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Këto të dhëna tregojnë se ka marrë pjesë në 15 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit administrativ të shkallës së parë.

Hetimi i Komisionit

33. Komisioni kërkoi informacion pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor në lidhje me ankesat e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit dhe masat disiplinore të marra ndaj saj nga viti 2006 e deri më sot.

34. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 30.7.2020, të Ministrisë së Drejtësisë, Komisioni vëren se ndaj subjektit është depozituar 1 ankesë nga shtetasi G. B., e vitit 2018, i cili, ndër të tjera, ankohet se nuk është vënë në dijeni të vendimit të dhënë nga ana e subjektit. Pas analizimit të kësaj ankese është konkluduar se ky pretendim nuk qëndron, pasi në faqen e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë rezulton i hedhur vendimi në datën 28.12.2016, me të cilin është vendosur kthimi i kërkesëpadsisë; kjo me arsyetimin se gjykata ka lënë afat për plotësimin e të metave të padsisë, për të cilin ankuesi është njohur nëpërmjet avokatit të tij me prokurë, z. S. V. Pasi të metat e lëna nga gjykata nuk janë plotësuar nga përfaqësuesi ligjor, konkretisht nuk ishte paguar taksa gjyqësore dhe nuk ishte paraqitur kopje e kërkesëpadsisë dhe akteve për Avokaturën e Shtetit, subjekti ka vendosur kthimin e padsisë.

35. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 14.8.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni vëren se ndaj subjektit janë depozituar 9 ankesa: në vitin 2008 – ankesa e shtetasit I.

T.; në vitin 2013 – dy ankesa të shtetasit A. J.; në vitin 2014 – ankesat e shtetasve H. P., A. J. dhe I. Morina; në vitin 2015 – ankesa e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare; në vitin 2017 – ankesa e shtetasit M. N.; në vitin 2018 – ankesa e shtetasit Sh. K., ndërkohë që ankesa e shtetasit I. Ç. është dorëzuar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Për këto ankesa është vendosur arkivimi i tyre. Pasi u shqyrtuan, vlerësohet se pretendimet ngrihen mbi themelin e vendimit, i cili nuk është objekt shqyrtimi nga ana e Komisionit.

36. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit Selvie Gjoçaj.

DENONCIME

37. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Selvie Gjoçaj janë administruar 12 denoncime nga publiku, respektivisht: (1) denoncimi nr. *** prot., datë 20.11.2017, i shtetasit H. P., i cili ankohet për disa subjekte rivlerësi, ndër ta edhe subjekti i rivlerësimit Selvie Gjoçaj, ku ankuesi ngre pretendime për dhënien e vendimeve të padrejta; (2) denoncimet nr. *** prot., datë 2.3.2018 dhe nr. *** prot., datë 6.3.2018, të shtetas D. K., e cila ankohet për 36 subjekte rivlerësi, ndër ta edhe subjekti i rivlerësimit Selvie Gjoçaj, ku ankuesja ngre pretendime për dhënien e vendimeve të padrejta; (3) denoncimi nr. *** prot., datë 22.6.2018, i shtetas F. C., e cila ngre pretendime ndaj subjektit të rivlerësimit për dhënien e një vendimi të padrejtë dhe të paarsyetuar mirë; (4) denoncimi nr. *** prot., datë 11.9.2018, i shtetasit A. D., i cili ngre pretendime ndaj subjektit të rivlerësimit për zhvillimin e një procesi gjyqësor jo të rregullt dhe dhënien e një vendimi të padrejtë; (5) denoncimi nr. *** prot., datë 20.11.2018, i shtetasit P. A., i cili ngre pretendime ndaj subjektit të rivlerësimit për dhënien e një vendimi të padrejtë, duke sjellë pasoja për pronën e tij; (6) denoncimet nr. *** prot., datë 22.10.2021, nr. *** prot., datë 16.2.2022, nr. *** prot., datë 9.3.2022 dhe nr. *** prot., datë 10.3.2022, të shtetasit S. H.; (7) denoncimet nr. *** prot., datë 25.10.2021 dhe nr. *** prot., datë 1.12.2021, të shtetas E. S., e cila ankohet pasi subjekti i rivlerësimit në vendimin e dhënë i ka shkaktuar dëm financiar.

Arsyetimi ligjor

38. Komisioni, pasi mori në shqyrtim ankesat e mësipërme, konstaton se pretendohen fakte që kanë lidhje me korrektësinë e vendimeve dhe me themelin e çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit E, fjalia e fundit e Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

39. Në përfundim, Komisioni, në vlerësimin tërësor të kriterit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Selvie Gjoçaj është “e aftë”, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është efiçente në masë të pranueshme.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Selvie Gjoçaj ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të gërmës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, dhe referuar gërmës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Selvie Gjoçaj, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 15.2.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Alma FASKAJ
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj